

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË BURREL

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Burrel me objekt: “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 143, datë 30.9.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 583 / 7, datë 30.9.2012, dërguar z. **Adelina FARRICI**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa që struktura e Policisë Bashkiake të ngrihet dhe funksionojë sipas kriterëve ligjorë të përcaktuar në VKM nr. 313, datë 01.7.2002 “Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës”, i ndryshuar, ku numri maksimal dhe struktura duhet të jetë 6 punonjës nga 8 që janë aktualisht.

Brenda muajit Dhjetor 2012

2. Për procedurat e prokurimit “Kërkesë për propozime” komisioni i vlerësimit të ofertave të përcaktohet në mënyrë nominative me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor.

Vazhdimisht

3. Dokumentet që argumentojnë sasinë, përcaktimin e çmimit të zërave të preventivit për përcaktimin e kufirit monetar duhet të jenë pjesë e dosjes së prokurimit.

Vazhdimisht

4. Njësia e prokurimit në kriteret e veçanta të kualifikimit duhet të vendosë kriteret kohore për periudha sa më të afërta me datën e zhvillimit të tenderit të cilat duhet të vërtetohen përmes dokumenteve të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

Vazhdimisht

5. Grupi për llogaritjen e kostos dhe fondit limit përveç procesverbaleve për përcaktimin e mënyrës së llogaritjes së çmimeve, duhet të detajojë dhe argumentojë procedurën e ndjekur në marrjen e çmimeve në treg. .

Vazhdimisht

6. Komisioni për Vlerësimin e Ofertave, anëtarët e tij në çdo rast duhet të nënshkruajnë procesverbalin e hapjes së procedurës, dhe për ato raste kur ndonjëri prej anëtarëve nuk nënshkruan duhet të paraqesë argumente në lidhje me mos nënshkrimin.

Vazhdimisht

7. Njësia e Prokurimit, grupi i punës për përllogaritjen e kostos dhe fondit limit apo dhe Komisioni për verifikimin e ankesave në çdo rast duhet që përveç nënshkrimit të akteve të prodhuara të kryejë dhe protokollimin e tyre.

Vazhdimisht

8. Komisioni për Vlerësimin e Ofertave në çdo rast duhet të kryej nënshkrimin e marrjes në dorëzim të dokumentacionit të subjektit fitues dhe për ato raste kur ndonjëri prej anëtarëve nuk nënshkruan duhet të paraqesë argumente në lidhje me mos nënshkrimin.

Vazhdimisht

9. Njësia e Prokurimit në çdo rast duhet ta administrojë si pjesë të dosjes së prokurimit skicimet, planimetritë dhe projekt preventivat e miratuara nga sektori i shërbimeve dhe përllogaritjen e fondit limit.

Vazhdimisht

10. Njësia e Prokurimit në çdo rast duhet të bëj pjesë të dosjes licencën e projektuesit dhe kontratën ndërmjet tij dhe bashkisë, për ato raste kur projekti realizohet me specialistë/ekspertë të jashtëm.

Vazhdimisht

11. Autoriteti Kontraktor në çdo rast duhet të bëj pjesë të dosjes miratimin e projektuesit për rastet e punime/investimeve në ndërtim, për të cilat gjatë kryerjes së investimit është kërkuar ndryshimi i projektit fillestar apo shtesë kontratë, për punime të paparashikuara.

Vazhdimisht

12. Autoriteti Kontraktor në çdo rast duhet të kërkojë sigurimin e kontratës për kryerjen e punimeve shtesë, në masë 10 % të vlerës shtesë së prokuruar, duke ndjekur të njëjtat kritere si në kushtet e përgjithshme të prokurimit, duke konsideruar shtesën e kontratës si një kontratë të re me kushte të barazvlefshme me kontratën bazë/fillestare.

Vazhdimisht

13. Autoriteti Kontraktor gjatë parashikimit të regjistrimit të shpenzimeve duhet që për çdo artikull apo grup artikujsh me natyrë të njëjtë, ti grupojë ato, duke mos ndjekur procedurën e prokurimit me blerje të vogla.

Vazhdimisht

14. Supervizimi i pastrimit të qytetit dhe mirëmbajtjes së varrezave duhet të bëhet vetëm nga punonjës të licencuar për realizimin e tyre, në mungesë të punonjësve me licencën përkatëse, të veprohet duke autorizuar ato punonjës me diplomë në inxhinieri e agronomi, sipas llojit të investimit.

Brenda muajit Dhjetor 2012

15. Taksa mbi biznesin e vogël, taksa e regjistrimit të automjeteve, taksa për zënie vendi në treg, të parashikohen bazuar mbi planifikimet e viteve të mëparshme dhe studime të mirëfillta për rritjen demografike të juridiksionit të kësaj bashkie.

Vazhdimisht

16. Për parashikimin dhe llogaritjen e saktë të ardhurave nga tarifa e pastrimit, bashkia për çdo vit të marrë për bazë evidencën e gjendjes civile për familjet që janë në fakt .

Vazhdimisht

17. Sektori i Financës duhet të pasqyrojë në kontabilitet në fund të vitit listat e debitorëve të dërguara nga zyra e taksave për detyrimet fiskale të vitit të mbyllur.

Vazhdimisht

18. Nga Zyra e Tatim Taksave të marren masat dhe të analizohet lista e subjekteve debitorë, me qëllim vjeljen e debitorëve të prapambetur, të cilët për vitin 2010 rezultojnë në 56 subjekte në vlerën prej 1,914 mijë lekë dhe për vitin 2011 në 45 subjekte në vlerën prej 1,195 mijë lekë.

Menjëherë

19. Nga Zyra e Tatim Taksave të marren masat në drejtim të ushtrimit të kontrolleve periodike, sipas drejtimeve të përcaktuara nga pika 10 e Udhëzimit të Përbashkët të MB dhe MF nr. 655/1, datë 06.02. 2001 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore” dhe të planifikojë ushtrimin e kontrolleve

Vazhdimisht

20. Bashkia Burrel në përmbushje të funksioneve të saj, në miratimin e strukturës organizative të institucionit duhet ti propozojë për miratim Këshillit Bashkiak një strukturë të plotë auditimi të brendshëm, duke miratuar njëherazi dhe rregullat e funksionimit të auditimit dhe garantimin e pavarësisë funksionale të tij, duke synuar gjithashtu rritjen e aftësive profesionale të stafit auditues me certifikatë audituesi dhe kualifikime të tjera.

Brenda muajit Dhjetor 2012

21. Bashkia Burrel në përmbushje të funksioneve e saj në miratimin e strukturës organizative të institucionit duhet ti propozojë për miratim Këshillit Bashkiak, rregulloren e re e funksionimit të institucionit, duke u vepruar në përputhje me kuadrin ligjor për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe duke u përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit punonjës dhe strukture brenda institucionit, njëherazi dhe masat ndëshkimore për mos përmbushje në kohë dhe cilësi të detyrave/objektiva. .

Brenda muajit Dhjetor 2012

22. Bashkia Burrel, të marrë masat për zbatimin e rekomandimit të KLSH-së dërguar me shkresën nr. 191/6, datë 04.11.2010, duke gjobitur në vlerën 50 mijë lekë ■■■ në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin: “Përmirësimi i kushteve të jetesës për nxënësit e konviktit të shkollës së mesme 28 Nëntori”.

Brenda muajit Dhjetor 2012

23. Bashkia Burrel, për ish-punonjësit e larguar nga puna të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, në rastin kur mos ushtrimi i detyrës administrative nga ana e tyre, ka ndikuar në funksionimin administrativ të Bashkisë, mbështetur kjo në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Dhjetor 2012

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **3,083,294 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit si më poshtë:

1. Janë emëruar në detyrë 2 punonjës policie mbi normativën e përcaktuar me VKM nr. 313, datë 01.07.2002 “Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës”,

me **efekt financiar prej 1,536,000 lekë**, nga të cilat për vitin 2010, 744 mijë lekë dhe për vitin 2011, 792 mijë lekë.

Për sa më lart, shuma **1,536,000 lekë**, duhet të zhdëmtohet, nga dy punonjësit e policisë të emëruar mbi normën e përcaktuar nga VKM. Në rast mos evidentimi të tyre, detyrimi tu vihet në ngarkim titullarëve të institucionit, sipas periudhave respektive të ushtrimit të detyrës.

Brenda muajit Dhjetor 2012

2. Në prokurimin me objekt: “Sistemim me sipërmarrje të mirëmbajtjes së varrezave publike dhe dëshmorëve”, aneks kontratës së lidhur i mungon objekti i lidhjes së saj për të justifikuar nënshkrimin e saj. Kjo kontratë është lidhur në kundërshtim me gërmën “b” të pikës 3 dhe pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, **dhe përbën dëm ekonomik në vlerën prej 518,832 lekë.**

Për sa më lart, shuma **518,832 lekë**, duhet të zhdëmtohet, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor i cili ka nënshkruar aneks kontratën shtesë.

Brenda muajit Dhjetor 2012

3. Nga pagesa e dietave për fjetje në hotel të klubit shumësportësh (futboll, basketboll, çiklizëm dhe pingpong) është konstatuar se në disa praktika dokumentacioni i administruar nuk rezultonte në përputhje me kuadrin ligjor, duke mos qenë i plotë apo i plotësuar jo rregullisht, duke u përlllogaritur një **dëm ekonomik buxhetit të shtetit (Bashkisë) prej 504,900 lekë.**

Për sa më lart, shuma **504,900 lekë** duhet të zhdëmtohet nga përfituesit nga ku për vitin 2010 për 39 persona përfitues në vlerën 225 mijë lekë dhe për vitin 2011 për 55 përfitues dhe vlerë 279,900 lekë, duke e kthyer shumën e mësipërme në buxhetin e Bashkisë Burrel.

Brenda muajit Dhjetor 2012

4. Në procedurën e prokurimit “Vendosje e tabelave, emërtim të rrugëve, parqeve, shesheve, bulevardëve, numrit të godinave dhe të sinjalistikës vertikale dhe horizontale në qytetin e Burrelit”, si pasojë e skualifikimit të padrejtë të ofertuesit ekonomik me ofertë më të ulët, [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] për ofertë anomalish të ulët duke shkaktuar një **dëm ekonomik buxhetit të shtetit (Bashkisë) prej 335,880 lekë.**

Për sa më lart, shuma **335,880 lekë** duhet të zhdëmtohet nga punonjësit, duke e kaluar shumën e mësipërme për llogari të buxhetit të Bashkisë Burrel..

Brenda muajit Dhjetor 2012

5. Në prokurimin me objekti “lyerje e çerdheve kopshteve dhe shkollave”, investimi si për kontratën bazë ashtu edhe për atë fillestare është bërë pa projekt preventiv apo skica të miratuar nga sektori i shërbimeve, po ashtu edhe shtesa e kontratës është bërë pa dokumentacion argumentues, si dhe pa u zbatuar procedurat e caktuara, duke mos u argumentuar nevoja e ndërhyrjes shtesë, në masën 20 % të kontratës fillestare, me një **efekt financiar prej 187,622 lekë.**

Për sa më lart, shuma **187,622 lekë**, duhet të zhdëmtohet, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor i cili ka nënshkruar aneks kontratën shtesë.

Brenda muajit Dhjetor 2012

C. MASA ADMINISTRATIVE

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar, ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 7, pika 2, 3/a, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që:

Në zbatim të nenit 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu X, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që bazuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe dokumenteve të tjera mbështetëse, si dhe duke vlerësuar dhe marrë parasysh rrethanat, pasojën dhe rolin e secilit prej zyrtarëve në shkelje, të vendosë gjoba në masën **50,000** lekë për:

1. z. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor
2. z. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
3. z. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
4. z. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për shkeljet e konstatuara në vlerësimin e prokurimeve publike të kryera nga Bashkia Burrel për vitet 2010, 2011, për:

- 1- Prokurimin e zhvilluar me objekt: “Blerje Dru Zjarri, gaz i lëngët dhe detergjent e materiale pastrimi D.D.”, të kryer në vitin 2010.
- 2- Prokurimin e zhvilluar me objekt: “Lyerje institucionesh, shkolla, kopshte dhe çerdhe në varësi të Bashkisë Burrel 2010”, të kryer në vitin 2010.
- 3- Prokurimin e zhvilluar me objekt: “Sistemim me sipërmarrje të mirëmbajtjes së varrezave publike dhe dëshmorëve”, të kryer në vitin 2011.
- 4- Prokurimin e zhvilluar me objekt: “Sistemim dy blloqe pallatesh lagjja”Pjetër Budi” Burrel”, të kryer në vitin 2011.
- 5- Prokurimin e zhvilluar me objekt: “Blerje Dru-zjarri për shkolla, kopshte dhe çerdhe 2011”, të kryer në vitin 2011.
- 6- Prokurimin e zhvilluar me objekt: “Vendosje e tabelave, emërtim të rrugëve, parqeve, shesheve, bulevardeve, numrit të godinave dhe të sinjalistikës vertikale dhe horizontale në qytetin e Burrelit”, të kryer në vitin 2011.

Shkeljet e konstatuara renditen si vijon:

Në prokurimin e zhvilluar me objekt: **“Blerje Dru Zjarri, gaz i lëngët dhe detergjent e materiale pastrimi D.D.”**. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura nga [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për Lotin 1 dhe 2, ka rezultuar se shoqëritë kanë mungesa apo parregullsi në dokumentacion si:

- Formulari i sigurimit të ofertës lëshuar nga Atlantik sh.p.k. në datë 26.02.2010 ka vlefshmëri për 90 ditë në kundërshtim me DST IV.4 “Periudha e vlefshmërisë së ofertave është 150 ditë”.
- Ofertuesit i mungon deklarata për konflikt interesi sipas shtojcës 17.
- Mungon deklarata për përmbushjen e specifikimeve teknike sipas shtojcës 15.

- Formulari i dorëzimit të ofertës sipas shtojcës 1, nuk është plotësuar me numrin e fletëve të dorëzuara.

- Vërtetim nr. 3596, datë 15.10.2009, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër është jashtë afateve të përcaktuar në DST (3 muaj), pra është kriter përjashtues.

- Vërtetim i Pushtetit Vendor Komuna Koms Mat për shlyerjen e detyrimeve që mban datë 16.01.2009 është jashtë afateve të përcaktuar në DST (3 muaj), është kriter përjashtues.

- Formulari i sigurimit të ofertës lëshuar nga Atlantik sh.p.k. në datë 26.02.2010 për lotin gaz i lëngshëm ka vlefshmëri për 90 ditë në kundërshtim me DST IV.4 “Periudha e vlefshmërisë së ofertave është 150 ditë”.

- Ofertuesit i mungon deklarata për konflikt interesi sipas shtojcës 17.

- Mungojnë dokumente që vërteton se subjekti ka kryer furnizime të së njëjtës natyre “gaz i lëngshëm” në 40% të vlerës të realizuara përgjatë dy viteve të fundit, është kriter përjashtues.

Për Loti 3 Blerje detergjente, materiale pastrimi dhe D.D Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura nga [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ka rezultuar se subjektet kanë mungesa apo parregullsi në dokumentacion si:

- Nga ekstrakti i QKR vërtetimi që nuk është i dënuar penalisht nuk përcaktohet që është për Shoqërinë Universi sh.p.k. pasi numri rendor 18 për këtë përcaktim nuk përputhet me numrin rendor të gjendjes së regjistrimit, është kriter përjashtues.

- Formulari i dorëzimit të ofertës sipas shtojcës 1 nuk është plotësuar me numrin e fletëve të dorëzuara.

- Ofertuesit i mungon deklarata për konflikt interesi sipas shtojcës 17.

Vendimi për Klasifikim është nënshkruar vetëm nga [REDAKTUAR]. pa u nënshkruar dy anëtarë të KVO-së [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të cilët nuk kanë paraqitur asnjë argument lidhur me mosnënshkrimin në kundërshtim gërmën “c” të pikës 1 të Kreut VI të VKM.

Dokumentet e paraqitura nga [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]. ka rezultuar se:

- Te Formulari i deklarimit të ofertës Shtojca 1, nuk është plotësuar numri i fletëve të dorëzuara.

- Vërtetimi Bankar nuk është vërtetuar me vulë të njomë nga As/drejtori i Degës dhe nënshkruësja [REDAKTUAR]

- Dokumentacioni ligjor i paraqitur nga subjekti R. dhe i pranuar nga KVO nuk është paraqitur për dy lotet të veçuara Loti 1 dhe 2 por për të dy Lotet së bashku, ndërkohë që bëhet fjalë për dy kontrata të ndryshme.

- Bilanci për vitin 2008 nuk është noterizuar dhe i njëjësuar me origjinalin në kundërshtim me DST.

Në prokurimin e zhvilluar me objekt: **“Lyerje institucionesh, shkolla, kopshte dhe çerdhe në varësi të Bashkisë Burrel 2010”**, nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura nga [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]. dhe [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]. ka rezultuar se ka mungesa apo parregullsi si:

- I mungon Licenca e kategorisë NP.3/A

- I mungojnë punë të ngjashme me vlerë 6.500.000 leke

- Vërtetim nr. 1, datë 04.3.2010 i Komunës Bushtrice ka kaluar afatin e vlefshmërisë, ky është kriter përjashtues.

- Mungon vërtetim për xhiron vjetore për vitin 2009. Vërtetimi i paraqitur përcakton xhiron vjetore për vitin 2008 dhe është me datë jashtë afateve të vlefshmërisë.

Procesverbal për marrjen në dorëzim të dokumentacionit të subjektit fitues nuk ka nënshkruar në marrjen në dorëzim të praktikës. Po kështu nuk është dhënë asnjë arsye për mosnënshkrim në kundërshtim me gërmën “i” pika 4 kreu V të VKM nr. 1 datë 10.01.2007.

Mbi procedurat e zbatimit të prokurimit nga shqyrtimi u konstatua si vijon:

Më datë 31.8.2010 administratori i shoqërisë [REDAKTUAR] ka njoftuar se kontrata me referencë nr. 09, UP. 67, datë 26.7.2010 ka përfunduar dhe kërkon marrjen e masave për të marrë në dorëzim objektet, po më këtë datë nga administratori i shoqërisë dhe nga Drejtorët e secilës çerdhe, kopsht dhe shkollë janë firmosur në mënyrë individuale aktet e marrjes në dorëzim të punimeve (copë 8).

Më datë 01.9.2010 është miratuar situacioni përfundimtar i punimeve i nënshkruar nga administratori i shoqërisë [REDAKTUAR] Kryetari i Bashkisë, Mbikëqyrësi i punimeve të bashkisë [REDAKTUAR] supervizori [REDAKTUAR]. Drejtuesi i Punimeve [REDAKTUAR]. dhe Kryetari i KVO [REDAKTUAR] dhe anëtari po i KVO [REDAKTUAR]

Më datën 01.9.2010 është hartuar shtesë kontrate për punime shtesë në lyerjen e ambienteve shkollore në varësi të bashkisë në vlerën 187,622 lekë pa TVSH ose 225,147 me t.v.sh. e barabartë me 20 % të vlerës fillestare të kontratës.

Më datë 06.9.2010 është miratuar situacioni përfundimtar i punimeve shtesë, dokumentacion i cili nuk është nënshkruar nga përgjegjësi i Zyrës së Shërbimeve Njerëzore, i ngarkuar si supervizor në rolin e mbikëqyrësit të punimeve, sipas përcaktimeve të bëra me nenin 9 të kontratës së sipërmarrjes.

Shtesa e kontratës “shërbimi shtesë” nuk rezulton të jetë bërë në mënyrë konsistente në rregullat dhe procedurat e parashikuara në ligj dhe nenit 17 “Ndryshimi i porosisë” së kontratës së sipërmarrjes.

Situacioni përfundimtar dhe punimet e kryera nuk janë kontrolluar dhe vërtetuar nga mbikëqyrësi i shërbimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar dhe UKM nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 17.

Më datë 06.9.2010 është miratuar situacioni përfundimtar i punimeve shtesë, kur sipas nenit 5 të kontratës shtesë të sipërmarrjes “Kushtet e dorëzimit të punimeve” kontraktuesi duhet të njoftojë AK 5 ditë para dorëzimit të shërbimit, pra brenda ditës pasi siç u sipër theksua situacioni përfundimtar është miratuar më datë 01.9.2010 ndërsa ai shtesë më datë 06.9.2010, po ashtu edhe fatura tatimore është prerë po më datë 06.9.2010.

Nuk është kryer procedura sipas nenit 14 “Mbarimi i shërbimeve” të kontratës shtesë pasi nuk i është paraqitur mbikëqyrësit të shërbimeve dokumentacioni për llogaritjen përfundimtare për shërbimet e kryera, duke mos u verifikuar prej tij.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, UKM nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr. 2, datë 15.2.2001 të Këshillit

të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar.

Nuk është bërë sigurimi i kontratës për kryerjen e punimeve shtesë, në masën 10 % të vlerës shtesë së prokuruar, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr. 1 datë 10.01.2007, kushtet e përgjithshme të prokurimit dhe nenin 10 "sigurimi i kontratës" e nenin 17 "Ndryshimi i porosisë" të kontratës bazë datë 26.7.2010.

Sa më sipër nuk argumentohet nevoja e ndërhyrjes dhe për rrjedhojë shtesa e kontratës në masën 20 % të kontratës fillestare, pra 187,622 lekë pa t.v.sh. ose 225,147 lekë me t.v.sh. dhe ngarkon me përgjegjësi ish-kryetarin e autoritetit kontraktor z. [REDAKTUAR]

Në prokurimin e zhvilluar me objekt: **"Sistemim me sipërmarrje të mirëmbajtjes së varrezave publike dhe dëshmorëve"**, ka rezultuar se ka mungesa apo parregullsi në dokumentacion si:

Procesverbali për hapjen e procedurës është nënshkruar vetëm nga Kryetari i KVO dhe jo nga anëtarët e tjerë të KVO dhe të gjithë zyrtarët e përfshirë në proces në kundërshtim gjërmën "c" të pikës 1 të Kreut VI të VKM. Anëtarët e tjerë nuk kanë dhënë arsye për mos nënshkrim.

- Nga shqyrtimi i dokumenteve të [REDAKTUAR] sh.p.k. ka rezultuar se te Formulari i deklarimit të ofertës Shtojca 1, nuk është plotësuar numri i fletëve të dorëzuara.

Kontrata është nënshkruar më datë 06.6.2011 midis bashkisë Burrel përfaqësuar nga Kryetari z. [REDAKTUAR] dhe Subjektit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]. përfaqësuar nga [REDAKTUAR] ndërsa më datë 10.6.2011 është nënshkruar Aneks Kontrata midis bashkisë Burrel përfaqësuar nga Kryetari z. [REDAKTUAR] dhe Subjektit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]. përfaqësuar nga [REDAKTUAR]

Në Nenin 1 të Aneks kontratës është parashikuar vlerë shtesë e kontratës datë 06.6.2011 në masën prej 518.832 lekë me t.v.sh. Kontratës i mungon objekti i lidhjes së saj për të justifikuar nënshkrimin e saj. Kjo kontratë është lidhur në kundërshtim me gjërmën "b" të pikës 3 dhe pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "për lëvrime shtesë nga furnizuesi i mëparshëm, për zëvendësimin e pjesshëm të lëvrimeve normale ose instalimeve apo si shtesë të mallrave, instalimeve ekzistuese, pasi ndryshimi i furnizuesit do ta detyrojë autoritetin kontraktor të kërkojë mallra me karakteristika të ndryshme teknike,.... Kontrata shtesë në këtë rast duhet të nënshkruhet brenda një afati 3 mujor nga përfundimi i kontratës kryesore." dhe përbën dëm ekonomik në vlerën prej 518.832 lekë, për të cilin mban përgjegjësi ish-Kryetari i Bashkisë z. [REDAKTUAR], në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor i cili ka lejuar dhe miratuar këto shkelje.

Në prokurimin e zhvilluar me objekt: **"Sistemim dy blloqe pallatesh lagjja" Pjetër Budi" Burrel**, nga shqyrtimi i dokumenteve [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]. dhe [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]. ka rezultuar se ka mungesa apo parregullsi në dokumentacion si:

- Është Paraqitur Vërtetimi nr. 3685, datë 23.11.2010 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, përkatësisht më shumë se tre muaj nga hapja e ofertave.

- Deklaratat për:

- a) për përmbushjen e specifikimeve teknike
- b) për konfliktin e interesave;
- c) mbi disponimin e makinerive

nuk i referohet procedurës së prokurimit me objekt “Sistemim dy blloqe pallatesh lagjja”Pjetër Budi” Burrel” me fond limit 1.816.426 lekë (pa tvsh) të zhvilluar nga Bashkia, por një procedure të zhvilluar nga Drejtoria e Rrugëve Rajonale Burrel.

- Mungon certifikata e marrjes në dorëzim të objektit “Rikonstruksioni i Rrugës Derjan Loti 1”.

- Nga ekstrakti i QKR vërtetimi që nuk është i dënuar penalisht nuk përcaktohet që është për Shoqërinë Universi sh.p.k pasi numri rendor 18 për këtë përcaktim nuk përputhet me numrin rendor të gjendjes së regjistrimit.

- Mungon formulari i vlerësimit sipas shtojcës 7.

- Mungon deklarata bankare për gjendjen financiare e lëshuar jo më parë se 10 ditë nga data e zhvillimit të tenderit.

- Mungon licenca profesionale e shoqërisë.

- Me vërtetim të Sigurimeve shoqërore nr. 133 datë 16.3.2011 konfirmohet se shoqëria ka paguar sig. shoq. për 2010 për 12 punonjës ndërkohë që në dokumentacionin standard janë kërkuar 15 punonjës për secilin vit 2009-2010.

- Sigurimi i ofertës nuk është i njëjtë me sigurimin e ofertës të paraqitur në sistem në formë elektronike. Në dokumentet e paraqitura zyrtarisht ndodhet një sigurim oferte për tender “sinjalistika dhe tabelat” me nr serial 038809 lëshuar nga Atlantik sh.a.

- Shtojca 5 dhe 6 nuk është për objektin e prokurimit në fjale por për tjetër objekt prokurimi.

- Në prokurimin e zhvilluar me objekt: **“Blerje Dru-zjarri për shkolla, kopshte dhe çerdhe 2011”**, ka rezultuar se ka mungesa apo parregullsi në dokumentacion si:

Me procesverbalin e datës 04.02.2011, është konstatuar se njeri nga anëtarët e KVO-se ka humbur passwordin si dhe kërkesa për pajisjen me password të ri nuk është nënshkruar nga njëri nga anëtarët e NjP dhe as nga KVO dhe vet personi M. S. i cili duhet ta konfirmonte këtë fakt. Po kështu nuk është protokolluar kërkesa për pajisje me password dhe kthimi i përgjigjes.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura nga ██████ sh.p.k. dhe ██████ sh.p.k. ka rezultuar se:

- Mungon kopje të xhiros vjetore për vitin 2010 sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e tenderit pika 2A “Kapaciteti financiar ekonomik” kopje të deklarimit të xhiros vjetore për vitet 2009-2010, ku për secilin vit xhiroja vjetore duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

- Në formularin e sigurimit të ofertës, mungon plotësimi i numrit të fletëve të dorëzuara.

- Në formularin e deklarimit të ofertës mungon plotësimi i numrit të fletëve të dorëzuara

- Vërtetimi bankar lëshuar nga BTK mban datën 16 prill 2010 përkatësisht 1 vit para zhvillimit të procedurës në kundërshtim me pikën 2/A/3 “kriteret e veçanta për kualifikim” një vërtetim për gjendjen financiare...lëshuar kjo jo më parë se 10 ditë nga data e zhvillimit të tenderit, kriter përjashtues.

- Mungon dokument për xhiron vjetore për vitin 2010 sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e tenderit pika 2A “Kapaciteti financiar ekonomik” kopje të deklarimit të xhiros vjetore për vitet 2009-2010, ku për secilin vit xhiroja vjetore duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

- Mungon vërtetim që ofertuesi nuk është në proces falimentimi, nuk është dënuar për shkelje penale, nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë sipas shtojcës 7 pika 1.

Mungon procesverbal i marrjes në dorëzim të dokumentacionit të subjektit fitues dhe nuk rezulton të ketë hyrë në protokoll.

Në prokurimin e zhvilluar me objekt: **“Vendosje e tabelave, emërtim të rrugëve, parqeve, shesheve, bulevardeve, numrit të godinave dhe të sinjalistikës vertikale dhe horizontale në qytetin e Burrelit”**, nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura nga [REDACTED] sh.p.k., [REDACTED] sh.p.k., [REDACTED] sh.p.k. dhe [REDACTED] sh.p.k. dhe bashkimi i operatoreve [REDACTED] ka rezultuar se ka mungesa apo parregullsi në dokumentacion si:

- Mungon kopje e bilancit dhe xhiros vjetore për vitin 2010 e “V.”, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e tenderit pika 2A “Kapaciteti financiar ekonomik” kopje të deklarimit të xhiros vjetore për vitet 2009-2010, ku për secilin vit xhiroja vjetore duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

- Në formularin e sigurimit të ofertës mungon plotësimi i numrit të fletëve të dorëzuara në përputhje me pikën 3.7 të DST.

- Mungon kopje të bilancit për vitin 2010 e [REDACTED] sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e tenderit pika 2A “Kapaciteti financiar ekonomik” kopje të deklarimit të xhiros vjetore për vitet 2009-2010, ku për secilin vit xhiroja vjetore duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

- Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura nga [REDACTED] sh.p.k. ka rezultuar se:

- Nga dokumentet e Mjetit të transportit në pronësi, i vërtetuar me kontratë shitblerje datë 14.3.2010 nuk ka të dhëna mbi kapacitetin mbajtës të mjetit.

- Kontrata për punë të ngjashme nuk është e vlefshme pasi objekti i kontratës së paraqitur është “Sistem asfaltim “Blloku Partizani” Burrel. Në preventiv zëri Sinjalistikë F.V tabela rrugore është 100 mijë lekë.

- Vërtetimi nr. 246, datë 12.6.2010 për numrin e kontribuesve, i referohet kontribuesve për vitin 2009 dhe jo për vitin 2011.

Me vendim date 17.3.2011 të KVO-së ka vendosur të skualifikoje Shoqëria [REDACTED] sh.p.k. dhe bashkimi i operatoreve [REDACTED] pasi kanë paraqitur ofertë anomalish të ulët.

Më datë 21.3.2011 subjekti R. sh.p.k. ka paraqitur ankesë lidhur me skualifikimin e tij.

Me Urdhër nr. 49, datë 21.3.2011 është pezulluar procedura e prokurimit për të marrë në shqyrtim ankesën për tenderin të subjektit “R.” sh.p.k. dhe është ngritur komisioni i vlerësimit të ankesës i cili ka arritur në konkluzionin se:

- Oferta e subjektit [REDACTED] sh.p.k. është anomalish e ulët sipas formulës;
- Subjekti [REDACTED] sh.p.k. nuk ka paraqitur mundësi për prodhimin e tabelave dhe aksesoret e tyre. Që të ketë mundësi për uljen e ofertës;

- Kushte të jashtëzakonshme për realizimin e objektit të tenderit dhe ka analizuar dy zëra të preventivit përkatësisht: FV tabele drejtkëndëshe 700x250x16mm emërtim rruge dhe zërin FV tabele drejtkëndëshe 700x250x3mm emërtim fasade.

Komisioni ka analizuar se çmimi është i njëjtë për të dy zërat gjë që nuk mund të jetë reale. Për sa më sipër ka miratuar vendimin e KVO për skualifikim.

Bazuar në nenin 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “kur autoriteti kontraktor verën se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve, janë anomalish të ulta, ai, përpara se ti refuzojë ato, kërkon me shkrim shpjegime për elementë të veçantë të ofertës... Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur” si dhe pikën 5.9 të DST theksohet se “... Autoriteti kontraktor mund ti kërkojë me shkrim ofertuesit të paraqesë detaje të mëtejshme mbi ofertën duke përfshirë dhe elemente të çmimit dhe përllogaritje të detajuar...”.

Nga shqyrtimi i dosjes të tenderit nuk rezulton që të ketë një kërkesë më shkrim të protokolluar për të dy ofertuesit ██████████ **sh.p.k. dhe bashkimi i operatoreve** ██████████. Kjo konfirmohet dhe me faktin që subjekti është ankimuar pasi KVO ka vendosur skualifikimin e tij për ofertë anomalish të ulët.

Nga shqyrtimi i ofertës së subjektit ██████████ sh.p.k. rezulton se ky subjekt ka paraqitur ofertë për zërin:

- FV tabele drejtkëndëshe 700x250x16mm emërtim rruge me çmim për njësi 4425 lekë; dhe

- FV tabele drejtkëndëshe 700x250x3mm emërtim fasade me çmim për njësi 4425 lekë.

Sipas KVA këto dy zëra nuk mund të kryen me të njëjtin çmim pasi kanë karakteristika të ndryshme.

Në shqyrtimin e ofertës së Subjektit ██████████ komisioni duhej të shqyrtonte çmimin e ofertave të tjera për të njëjtin zë. Me saktësisht edhe oferta e shoqërisë “V.” parashikon realizimin e këtij zëri me vlerat e mëposhtme:

- FV tabele drejtkëndëshe 700x250x16mm emërtim rruge me çmim për njësi 2,900 lekë; dhe

- FV tabele drejtkëndëshe 700x250x3mm emërtim fasade me çmim për njësi 2,900 leke.

Për sa më sipër, KVA ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 dhe 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, duke mos siguruar trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurën prokurimit. KVO dhe KVA kane skualifikuar shoqërinë ██████████ sh.p.k. duke mos respektuar nenin 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Dokumenteve Standarde të Tenderit. **Autoriteti Kontraktor duhet të mos s’kualifikonte shoqërinë ██████████ sh.p.k. për oferte anomalish të ulët** dhe të vepronte në përputhje me pikën 1 të nenit 55 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006, duke nënshkruar kontratën me ofertuesin që ka paraqitur ofertën më të ulët. **Me veprimet e mësipërme i është shkaktuar një dëm ekonomik buxhetit të shtetit (Bashkisë) në masën prej 335,880 lekë.**

Procesverbali i marrjes në dorëzim të dokumentacionit të subjektit fitues nuk mban datë dhe nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit në përputhje me pikën 2 të Kreut V të VKM nr. 1, datë 10.01.2007.

Dokumentacioni i sjellë nga shoqëria e shpallur fituese është i fotokopjuar, në kundërshtim me DST ku përcaktohet se “dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose i noterizuar njësuar me origjinalin”.

Kushtet e Përgjithshme të kontratës, nuk janë nënshkruar në të gjitha fletët nga titullari i autoritetit kontraktor.

Konstatimet mbi veprimet e kryera nga punonjësit, janë në kundërshtim me ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” e ndryshuar. (Shih Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalin nr. 4 dhe 5, datë 12.7.2012).

D.1 MASA DISIPLINORE

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar, dhe në zbatim të nenit 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu X, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që bazuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe dokumenteve të tjera mbështetëse, si dhe duke vlerësuar dhe marrë parasysh rrethanat, pasojën dhe rolin e secilit prej zyrtarëve në shkelje, të propozojë masa disiplinore për:

1. z. ████████ në cilësinë e ish-Juristit të Njesisë së Prokurimit
2. zj. ████████ në cilësinë e ish-Specialistes të Njesisë së Prokurimit.
3. z. ████████ në cilësinë e ish-Specialistit të Njesisë së Prokurimit.

Për shkeljet e konstatuara në procesin e hartimit dhe administrimit të dokumentacionit të prokurimeve publike të kryera nga Bashkia Burrel për vitet 2010, 2011, për:

- 1- Prokurimin e zhvilluar me objekt: “Blerje Dru Zjarri, gaz i lëngët dhe detergjent e materiale pastrimi D. D.”, të kryer në vitin 2010.
- 2- Prokurimin e zhvilluar me objekt: “Lyerje institucionesh, shkolla, kopshte dhe çerdhe në varësi të Bashkisë Burrel 2010”, të kryer në vitin 2010.
- 3- Prokurimin e zhvilluar me objekt: “Sistemim me sipërmarrje të mirëmbajtjes së varrezave publike dhe dëshmorëve”, të kryer në vitin 2011.
- 4- Prokurimin e zhvilluar me objekt: “Sistemim dy blloqe pallatesh lagjja”Pjetër Budi” Burrel”, të kryer në vitin 2011.
- 5- Prokurimin e zhvilluar me objekt: “Blerje Dru-zjarri për shkolla, kopshte dhe çerdhe 2011”, të kryer në vitin 2011.
- 6- Prokurimin e zhvilluar me objekt: “Vendosje e tabelave, emërtim të rrugëve, parqeve, shesheve, bulevardeve, numrit të godinave dhe të sinjalistikës vertikale dhe horizontale në qytetin e Burrelit”, të kryer në vitin 2011.

Shkeljet e konstatuara renditen si vijon:

Në procedurat e prokurimit, të audituara, në dosjen e prokurimit nuk është administruar fizikisht si pjesë e saj njoftimi i prokurimit të institucionit për botimin në Buletin e Njoftimeve Publike të procedurës, veprim ky në kundërshtim me pikën 1 kreu V e pikën 1 Kreu VI të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, veprime për të cilat mban përgjegjësi NJP.

Në procedurat e prokurimit “Kërkesë për propozime” komisioni i vlerësimit të ofertave nuk është përcaktuar në mënyrë nominative me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor, por i referohet Urdhrit nr. 4, datë 04.01.2010 i cili është hartuar dhe miratuar përpara VKB-së që mban nr. 8, datë 21.02.2011, në kundërshtim me gjurmën a të pikës 1 të kreut VI të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, veprime për të cilat mban përgjegjësi Titullari i Autoriteti Kontraktor dhe NJP.

Në procedurat e prokurimit, të audituara, në dosjen e prokurimit nuk është administruar fizikisht si pjesë e saj shkresa drejtuar APP për botimin e Njoftimit të Fituesit në kundërshtim me gjurmën “h” pikës 4 të kreut V të VKM nr. 1 datë 10.01.2007, veprime për të cilat mban përgjegjësi NJP.

Në procedurat e prokurimit, të audituara, në dosjen e prokurimit nuk është administruar fizikisht procesverbali i regjistrimit të procedurës së prokurimit për regjistrimin e çdo faze të procesit në kundërshtim me gjurmën “i” pikës 4 të kreut V të VKM nr. 1 datë 10.01.2007, veprime për të cilat mban përgjegjësi NJP.

Në prokurimin e zhvilluar me objekt: **“Blerje Dru Zjarri, gaz i lëngët dhe detergjent e materiale pastrimi D.D.”**, Komisioni i ngritur komisioni për llogaritjen e kostos dhe të fondit limit për artikujt, i përberë nga [REDAKTUAR] Kryetar; [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] anëtar, nuk ka detajuar dhe argumentuar procedurën që ka ndjekur për të marrë çmimet në treg, ofertat e marra për të arritur në përcaktimin e çmimit. Procesverbali datë 07.01.2010 që i bashkëlidhet procesverbalit datë 24.01.2010 nuk i referohet Urdhrit nr. 9, datë 15.01.2010, veprime për të cilat mban përgjegjësi NJP për llogaritjen e kostos duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu II, pika 2, germa ç, “Autoriteti kontraktor, në çdo rast, analizon koston e mallrave, të shërbimeve dhe punëve, që do të prokurohen..... dhe, në çdo rast, i dokumenton ato”.

Në prokurimin e zhvilluar me objekt: **“Lyerje institucionesh, shkolla, kopshte dhe çerdhe në varësi të Bashkisë Burrel 2010”**, ka rezultuar se ka mungesa apo parregullsi në dokumentacion si:

Në dosjen e prokurimit nuk ka një projekt preventiv të miratuar nga sektori i shërbimeve, duke u vepruar vetëm mbi bazën e preventivit të investimeve të bëra nga preventivuesi [REDAKTUAR] dhe të miratuar nga kryetari i bashkisë. Nuk ka licencën e projektuesit [REDAKTUAR] dhe as kontratën ndërmjet Bashkisë Burrel dhe subjektit në fjalë.

Mungojnë skicimet dhe planimetritë e objektit si pjesë e dokumenteve standarde të tenderit.

Procesverbali i mbajtur më datë 27.4.2010 nga NJP për përcaktimin e procedurave të prokurimit, forma e prokurimit, kriteret e kualifikimit, ato

teknike e profesionale, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit, është nënshkruar vetëm nga juristi i njësisë.

Shkresa e Përgjegjësit të Zyrës së Taksave për përcjelljen e listës së subjekteve juridik që kanë aktivitet në fushën e ndërtimit dhe shërbimit nuk mban numër protokoll dhe as datë në kundërshtim me ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003.

Urdhri i Kryetarit për të urdhëruar pjesëmarrjen në prokurimin e datës 18.5.2010, mban numër 71 dhe tre data të ndryshme 03.4.2010; 03.5.2010 dhe 07.6.2010, dhe për më tepër është hartuar në kundërshtim me ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, gjithashtu bie edhe në kundërshtim me germën “b” pika 1 e Kreut IV të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, pasi përcaktimi dhe njoftimi i subjekteve që do të marrin pjese ne procedure është detyre e NJP.

Po kështu edhe shkresa nr. 437, datë 07.6.2010 duhet të hartohet nga NjP.

Bazuar në germën b të pikës 1 të VI të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 është dërguar ftesa për ofertë të pesë subjekte në mënyrë elektronike në sistem. Marrjen dijani për ftesën e kanë konfirmuar vetëm tre operatore ekonomik, ■■■■■ sh.p.k. më datë 07.6.2010, ■■■■■ sh.p.k. më datë 07.6.2010 dhe ■■■■■ inp/eks më datë 07.6.2010. Dy operatorët e tjerë nuk kanë konfirmuar marrjen e ftesës.

Në Njoftimin në sistem elektronik, nuk janë përcaktuar të dhënat e shoqërive të thirrura për të marrë pjesë.

Procesverbali për miratimin e dokumenteve të tenderit është nënshkruar vetëm nga ■■■ Jurist i NJP, ndërsa 2 anëtarët ■■■ dhe ■■■ nuk kanë nënshkruar dhe nuk kanë paraqitur asnjë argument në lidhje me mosnënshkrimin në kundërshtim me germën “c” të pikës 1 të Kreut VI të VKM.

Procesverbali për miratimin e dokumenteve të tenderit përshkrimi “Përvojë e suksesshme për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë në një vlerë 6.500.000 leke...”, është në kundërshtim me pikën 4.5 të DTS “shërbime të mëparshme të ngjashme me një vlerë deri në 40% të vlerës së fondit limit ... të realizuar gjatë tre viteve të fundit”.

Dokumentet standarde janë të nënshkruara vetëm nga dy anëtarë të NJP konkretisht nga ■■■■■ dhe njëra nga firmat nuk identifikohet me emër. DST nuk janë të plotësuara me të dhënat përkatëse për prokurimin, më konkretisht: Seksioni III.1.1’1.2;1.3; Pikat IV.3 dhe IV.4 i referohen datës 21.5.2010 ora 10:00 dhe jo datës 18.6.2010 sipas njoftimit në buletin. Pikat 3.17,3.18,3.19;4.5 janë të pa plotësuara.

Në prokurimin e zhvilluar me objekt: **“Sistemim me sipërmarrje të mirëmbajtjes së varrezave publike dhe dëshmorëve ”**, ka rezultuar se ka mungesa apo parregullsi në dokumentacion si:

Bazuar në germën b të pikës 1 të VI të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, është dërguar ftesa për ofertë te pesë subjekte në mënyrë elektronike ne sistem. Nuk gjenden në dosje njoftimet për pjesëmarrje në mënyrë që të vërtetohet që subjektet kanë marrë dijani. Në Njoftimin në sistem elektronik nuk janë përcaktuar të dhënat e shoqërive të thirrura për të marrë pjesë.

Dokumentet standardet të miratuara nga NjP nuk janë të plotësuara me të dhënat përkatëse për prokurimin, më konkretisht: Seksioni III faqe 5; pikat 3.17,3.18,3.19 faqe 11; pika 3.23, faqe 13.

Mungon preventivi i miratuar nga titullari për këtë procedurë.

Në dosjen e prokurimit nuk janë dokumentet që argumentojnë përcaktimin e çmimit të zërave të punimit të preventivit për përcaktimin e kufirit monetar sipas përcaktimit të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu II, pika 2, germa ç, “Autoriteti kontraktor, në çdo rast, analizon koston e mallrave, të shërbimeve dhe punëve, që do të prokurohen..... dhe, në çdo rast, i dokumenton ato”.

Në prokurimin e zhvilluar me objekt: **“Sistemim dy blloqe pallatesh lagjja “Pjetër Budi” Burrel**, ka rezultuar se ka mungesa apo parregullsi në dokumentacion si:

Është dërguar ftesa për ofertë pesë subjekteve, nga ku vetëm dy prej shoqërive kanë konfirmuar marrjen e ftesës për ofertë të cilat kanë vulosur për marrjen dijani, ndërsa Shoqëritë █████ sh.p.k. █████ sh.p.k. dhe █████ sh.p.k. nuk kanë nënshkruar marrjen dijani të ftesës. Ftesat për ofertë nuk mbajnë nr. Protokollit por vetëm datën. Mungesa e numrit të protokollit nuk vërteton se kur kanë marrë ftesën për ofertë shoqëritë.

Njoftimin në sistem elektronik nuk janë përcaktuar të dhënat e shoqërive të thirrura për të marrë pjesë.

Dokumentet standardet të miratuara nga NjP nuk janë të plotësuara me të dhënat përkatëse për prokurimin, më konkretisht: Seksioni III faqe 5; pikat 3.17,3.18,3.19 faqe 11; pika 2.23, faqe 12; 4.7 faqe 13-14. Formulari i çmimit të ofertës nuk është i plotësuar me përshkrimin e punëve, njësi sasi faqe 23. Seksioni II “Informacion për procedurën”

Mungojnë skicimet dhe planimetritë e objektit si pjesë e dokumenteve standarde të tenderit.

Mungon grafiku i zbatimit të punimeve.

Nuk janë miratuar specifikimet teknike të procedurës dhe këtë e vërteton dhe fakti që specifikimet e ndodhura në dosje nuk janë të nënshkruara nga Njësia e prokurimit apo nga ndonjë strukturë e specializuar.

Preventivi nuk është nënshkruar nga titullari i institucionit.

Në dosjen e prokurimit nuk janë dokumentet që argumentojnë përcaktimin e çmimit të zërave të punimit të preventivit për përcaktimin e kufirit monetar sipas përcaktimit të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu II, pika 2, germa ç, “Autoriteti kontraktor, në çdo rast, analizon koston e mallrave, të shërbimeve dhe punëve, që do të prokurohen..... dhe, në çdo rast, i dokumenton ato”.

Në prokurimin e zhvilluar me objekt: **“Blerje Dru-zjarri për shkolla, kopshte dhe çerdhe 2011”**, ka rezultuar se ka mungesa apo parregullsi në dokumentacion si:

Është dërguar ftesa për ofertë pesë subjekteve nga ku katër prej subjekteve kanë konfirmuar marrjen e ftesës për ofertë dhe kanë vulosur për marrjen dijani ndërsa shoqëria █████ sh.p.k. nuk ka nënshkruar marrjen dijani të ftesës.

Njoftimi në sistemin elektronik nuk ka përcaktuar të dhënat e shoqërive të thirrura për të marrë pjesë █████ dhe █████ nuk janë njoftuar në sistem elektronik.

Procesverbali për miratimin e dokumenteve të tenderit, nuk është nënshkruar në të gjitha fletët nga anëtarët e njësisë po kështu nuk është nënshkruar edhe nga anëtari i njësisë █████

Dokumentet standarde të miratuara nga NjP nuk janë të plotësuar me të dhënat përkatëse për prokurimin, më konkretisht: Seksioni III faqe 5 pikat 1.1, 1.2 1.3; Seksioni IV IV.3 dhe IV.4 kanë datën e zhvillimit gabim faqe 6; pika 3.17, 3.18, 3.19,3.23, nuk janë plotësuar.

Në testimin e tregut komisioni për llogaritjen e vlerës së kontratës i është drejtuar vetëm dy subjekteve, për të marrë çmime. Numri minimal i subjekteve nuk siguron që çmimi i tregut është ky.

Preventivi i plotësuar me zëra sasi dhe vlerë totale, nuk është nënshkruar nga titullari i institucionit.

Në prokurimin e zhvilluar me objekt: **“Vendosje e tabelave, emërtim të rrugëve, parqeve, shesheve, bulevardeve, numrit të godinave dhe të sinjalistikës vertikale dhe horizontale në qytetin e Burrelit”**, ka rezultuar se ka mungesa apo parregullsi në dokumentacion si:

Në dosjen e prokurimit nuk janë dokumentet që argumentojnë përcaktimin e çmimit të zërave të punimit të preventivit për përcaktimin e kufirit monetar sipas përcaktimit të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu II, pika 2, germa ç, “Autoriteti kontraktor, në çdo rast, analizon koston e mallrave, të shërbimeve dhe punëve, që do të prokurohen..... dhe, në çdo rast, i dokumenton ato”.

Është dërguar ftesa për ofertë të 5 subjekteve nga ku katër prej subjekteve kanë konfirmuar marrjen e ftesës për ofertë ndërsa Shoqëria ██████ sh.p.k. nuk ka nënshkruar marrjen dijani të ftesës.

Në Njoftimin në sistem elektronik nuk janë përcaktuar të dhënat e shoqërive të thirrura për të marrë pjesë.

Procesverbali për miratimin e dokumenteve të tenderit, nuk është nënshkruar në të gjitha fletët nga anëtarët e NJP.

Dokumentet standarde të miratuara nga NjP nuk janë të plotësuar me të dhënat përkatëse për prokurimin, më konkretisht: Seksioni III faqe 5 pikat 1.1, 1.2 1.3; Seksioni IV .3 dhe IV.4 kanë datën e zhvillimit gabim faqe 6; pika 3.17, 3.18, 3.19,3.23 nuk janë plotësuar.

Konstatimet mbi veprimet e kryera nga punonjësit, janë në kundërshtim me ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” e ndryshuar. (Shih Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalin nr. 4 dhe 5, datë 12.7.2012).

D. 2 MASA DISIPLINORE

I- Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të VKM nr. 306, datë 13.6.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore: **“Vërejtje me paralajmërim”**, neni 25, pika 3, germa “b”, për:

1. ██████ me detyrë specialiste e Zyrës së Financës, në cilësinë e anëtares së komisionit me blerje të vogla, pasi nga auditimi, analizimi dhe grupimi i artikujve dhe faturave me blerje më vlera të vogla, rezultoi se për vitin 2010 realisht për disa artikuj e grup artikujsh të të njëjtës natyrë është vepruar në tejkalim të kufirit monetar prej 400 mijë lekë, duke mos u zbatuar plotësisht referencat ligjore dhe konkretisht ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, VKM nr. 1,

datë 10.01.2007 dhe Udhëzimi i APP nr. 2, datë 18.02.2008, për disa procedura me vlera të vogla. (Shih procesverbalin nr. 1 datë 10.7.2012).

2. ■■■ me detyrë ish-specialiste e Zyrës së Financës, (aktualisht Specialiste e Zyrës së Taksave) në cilësinë e specialistes së dietave të klubit shumësportësh, pasi nga auditimi, është konstatuar nga pagesa e dietave për fjetje në hotel të klubit shumësportësh (futboll, basketboll, çiklizëm dhe pingpong), për disa praktika dokumentacioni i administruar nuk rezultonte në përputhje me kuadrin ligjor, duke u përlllogaritur një dëm ekonomik buxhetit të shtetit (Bashkisë) prej 504,900 lekë nga ku për 39 persona përfitues për vitin 2010 dhe 55 për 2011. (Shih procesverbalin nr. 2 dhe 3 datë 11.7.2012)

3. ■■■ me detyrë ish-specialiste e Zyrës së Taksave (aktualisht Përgjegjëse e Zyrës së Taksave), në cilësinë e specialistes së taksave, për mosrealizim të taksave dhe tarifave vendore, si rezultat e planifikimit me tepriçë me qëllim rritjen e investimeve, por dhe si rezultat i punës së dobët të zyrës së taksave (Shih aktverifikimi nr. 4 datë 11.7.2012).

II- Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të VKM nr. 306, datë 13.6.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore: **“Pezullimi nga e drejta e ngritjes në detyrë, për një periudhë deri në dy vjet”, neni 25, pika 3, germa “c”, për:**

1. ■■■ me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së Taksave Financës, (aktualisht specialist i auditit), për mosrealizim të taksave dhe tarifave vendore, si rezultat e planifikimit me tepriçë me qëllim rritjen e investimeve, por dhe si rezultat i punës së dobët të zyrës së taksave.

2. ■■■ me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve të Brendshme, (aktualisht inspektor i Burimeve Njerëzore), për emërimin në detyrë të 2 punonjës policie mbi normativën e përcaktuar me VKM nr. 313, datë 01.07.2002 “Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës”, me **efekt financiar prej 1536 mijë lekë.**

III- Mbështetur në nenin 37 e 140 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe kontratës të punës, kërkojmë që të fillojë procedura për dhënien e masës disiplinore: **“Vërejtje me shkrim”**, për:

- ■■■ me detyrë specialist i arkivit, në cilësinë e anëtarit të komisionit me blerje të vogla, pasi nga auditimi, analizimi dhe grupimi i artikujve dhe faturave me blerje të vogla, rezultoi se për vitin 2010 realisht për disa artikuj e grup artikujsh të njëjtës natyrë, është vepruar në tejkalim të kufirit monetar prej 400 mijë lekë, duke mos u zbatuar plotësisht referencat ligjore dhe konkretisht ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 dhe Udhëzimi i APP nr. 2, datë 18.02.2008, për disa procedura me vlera të vogla.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Selman Hysaj, Rysisim Xhaja dhe Edvin Morava. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Bajram Lamaj, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT